



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 143 dt.10.06.1994

**PER**  
**RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLAVE DREJTUESE TE**  
**NDERMARRJEVE LOKALE TE TREGTISE**  
**DHE INDUSTRISE USHQIMORE**

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.10.06.1994, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore, në zbatim të V.K.M. Nr.623, dt.31.12.1993

**VENDOSI**

1. Të rrisë pagat e drejtorëve të ndërmarrjeve si më poshtë :

- Ndërmarrja e Prodhim Konserv Makarona 6.500 lekë
- Ndërmarrja e Përpunim Rrushit 6.500 lekë
- Ndërmarrja e Kartolerisë 6.500 lekë
- Ndërmarrja Energjitike e Ind.Ushqimore 6.500 lekë
- Ndërmarrja Prodhime Sheqeri 6.500 lekë
- Ndërmarrja e Furnizimit të Mencave 6.000 lekë

- Ndërmarrja Tregtare Ushqimore Nr.1 6.500 lekë
  - Ndërmarrja Tregtare Ushqimore Nr.2 6.500 lekë
  - Ndërmarrja Tregtare Ushqimore Nr.3 6.500 lekë
  - Ndërmarrja Prodhim Ëmbëlsira 6.500 lekë
  - Ndërmarrja e Tregut të Lirë 6.500 lekë
  - N.T.U.S. Nr.3 6.000 lekë
2. Antarët të Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes, kur kanë detyrën e Kryetarit të Degës, marrin 15% më pak se paga e drejtorit, specialistët antarë të K.Drejtues marrin 25% më pak se paga e drejtorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi që nga 1 Janari 1994.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**